



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-62

PËR INSPEKTORATIN E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1. (ç), dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

me qëllim të krijimit të bazës ligjore për Inspektimin e zbatimit të punimeve gjatë prodhimit dhe tregtimit të produkteve të ndërtimit,

Miraton:

LIGJIN PËR INSPEKTORATIN E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT

KREU I
DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- (1) Të sigurojë inspektimin e cilësisë së produkteve të ndërtimit të prodhuara për inkorporim të përhershëm në punët ndërtimore, të garantojë se ato produkte dizajnohen dhe zbatohen në një mënyrë që nuk e rrezikon sigurinë e personave, të mjedisit dhe pronës.
- (2) Të përcaktojë kuadrin rregullator dhe institucional për themelimin dhe funksionimin e Inspektoratit të produkteve të ndërtimit, si njësi në kuadër të Inspeksionit të tregut, e specializuar për inspektim në fushën e përcaktuar me këtë ligj.
- (3) Ta rregullojë organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e njësisë së Inspektoratit të produkteve të ndërtimit.
- (4) Të inspektojë respektimin e kritereve të parapara për licencimin e ndërmarreve nga fushëveprimtaria e Kuadrit rregullator e institucional.

Neni 2
Fushat e zbatimit

Ky ligj zbatohet nga organet kompetente në fushën e produkteve të ndërtimit në territorin e Kosovës.

Neni 3
Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:

“**Punime ndërtimi**”, nënkupton ndërtimin e objekteve dhe punimeve në fushën e inxhinierisë civile.

“**Produkt ndërtimi**”, nënkupton çdo produkt, i prodhuar për tu përdorur, në mënyrë të përhershme, në punimet e ndërtimit.

“**Inspektorati**”, nënkupton organin në kuadër të Inspeksionit të tregut, i specializuar për inspektim në fushën e përcaktuar me këtë ligj.

“**Inspektor**” nënkupton personin zyrtar, specialist në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe teknologjisë së produkteve të ndërtimit, që inspekton zbatimin e këtij Ligji.

“**Inspektim**” nënkupton veprimtarin kontrolluese që kryhet nga inspektorët e Inspektoratit të produkteve të ndërtimit, me qëllim të zbatimit të këtij ligji.

“**Pezullim**” nënkupton ndalimin e përkohshëm të procesit të prodhimit e tregtimit të produkteve të ndërtimit nga inspektori.

“**Bllokim**” nënkupton ndalimin e procesit të zbatimit të punimeve të prodhimit dhe të tregtimit të produkteve të ndërtimit më qëllim të zbatimit të kriterëve, rregullave dhe kushteve teknike për prodhimin apo shfrytëzimin e produkteve të ndërtimit.

“**Ministria**”- nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

“**Kuadri rregullator e institucional**” - nënkupton ministrin e Tregtisë dhe Industrisë.

“**Rregulla teknike**”- janë aktet nënligjore me karakter teknik të cilat i përcaktojnë karakteristikat e produkteve, proceset e prodhimit të tyre, ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen në rast të shkeljes së tyre. Rregullat teknike mund të përmbajnë terminologjinë, simbolet, ambalazhin, shënimet ose kërkesat për etiketimin që kanë të bëjnë me produktin, procesin apo metodën e prodhimit.

” **Person**” nënkupton personin fizik dhe juridik.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 4
Statusi i inspektoratit

4.1. Inspektorati është organ ekzekutiv, i themeluar në kuadër të Inspeksionit të tregut.

4.2. Punët e inspektimit i kryen inspektorati përmes organizimit të brendshëm në tërë territorin e Kosovës dhe e inspektorateve në regjione.

4.3. Inspektorati përbëhet nga kryeinspektori dhe inspektorët në qendër dhe regjione dhe inspekton ndërmarrjet prodhuese dhe tregtare të produkteve të ndërtimit dhe inspektimin e liçensave në fushë veprimtarinë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

4.4. Inspektorati duhet t'i ketë uniformën, pajisjet, makinerinë si dhe mekanizmat e tjerë për ushtrimin e veprimtarisë së tij.

4.5. Inspektorët pajisen me kartelë identifikimi të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, forma dhe përmbajtja e së cilës përcaktohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 5 Kompetencat e inspektoratit

Inspektorati ka këto kompetenca:

- (1) Inspekton zbatueshmërinë e rregullave teknike të prodhimit dhe tregtimit të produkteve të ndërtimit;
- (2) Raporton, me shkrim, sistematikisht organet vendimmarrëse dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për cenimin e legjislacionit në fushën e shtrirjes së këtij Ligji;
- (3) Të ushtrojë inspektimin, sipas legjislacionit në fuqi dhe fushë veprimtaria e këtij Ligji;
- (4) Të kontrollojë produktet ndërtimore, pajisjet, aparatet, repromaterialin për prodhim, përpunim dhe finalizim, si dhe prodhimet në të gjitha fazat e prodhimit dhe në të gjitha vendet ku gjenden dhe dokumentacionin tjetër përkatës të nevojshëm më qellim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore;
- (5) Të marr vendim për shkatërrimin e produkteve që nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara me ligj;
- (6) Të hyjë në çdo kohë gjatë orarit të punës, në prani të drejtuesit apo përfaqësuesit të tij, në reparte, linja prodhimi e shfrytëzimi dhe qendra tregtimi ku ushtrojnë veprimtari subjektet e përshkruara në këtë Ligj;
- (7) Në rastet e inspektimit të programuar, zyrtarisht dhe paraprakisht njoftohet drejtuesi i subjektit për objektin e planifikuar për inspektim;
- (8) Të kërkojë kryerjen e çdo lloj, prove apo analize, që e konsideron të nevojshme për tu siguruar për zbatimin e kërkesave të ligjit;
- (9) Për mos zbatimin e dispozitave ligjore, të lëshoj akt-kontroll për mënjanimin e parregullsive me detyra e afate, të vërë gjobë dhe kur nuk plotësohen kriteret që kërkohen, të lëshoj urdhër bllokimi, pezullimi deri në konfiskim;
- (10) Të thërrasë ekspertë dhe organe për realizimin e detyrave kur ato janë të nevojshme për mbarëvajtjen e punëve;
- (11) Të urdhërojë me shkrim evitimin e parregullsive apo të mungesave gjatë kryerjes së punëve për një afat të caktuar kohor;
- (12) Kryen detyra të tjera të përcaktuara me Ligj.

Neni 6 Të drejtat e Inspektoratit

Inspektorati, ka të drejtë të:

- (1) Kërkoj dokumentacionin teknik e ligjor mbi ushtrimin e veprimtarisë duke përfshirë Licencat, certifikatat, atestet e provave laboratorike dhe dokumentacione të tjera shoqëruese;
- (2) Ndaloj veprimtarinë e subjekteve, kur nuk zbatohen rregullat teknike të prodhimit e tregtimit të produkteve të ndërtimit që përbëjnë rrezik për jetën, shëndetin, mjedisin dhe pronën e njerëzve dhe kur punimet nuk përputhen me klasat e kategoritë e licensës profesionale;
- (3) Bllokoj ato produkte e elemente ndërtimi që hyjnë e qarkullojnë në treg, e që gjatë përdorimit nuk plotësojnë kërkesat themelore për mbrojtjen e shëndetit, jetës së njeriut dhe të mjedisit;
- (4) Pezulloj tregtimin e përkohshëm të produkteve të ndërtimit të pashoqëruar me dokumentacionin e vlerësimit të konformitetit;
- (5) Konfisko ato produkte ndërtimore të cilat paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën e njeriut, mjedisit dhe pronës, si dhe të gjitha ato produkte ndërtimore që janë vu në qarkullim në mënyra jo të rregullta në territorin e Kosovës;
- (6) Kontrolluj licensat profesionale të ndërmarrjes, të lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, sipas Ligjit;
- (7) Propozoj heqjen e licensës profesionale, subjekteve dhe drejtuesve teknik të tyre për shkak të shkeljeve të rregullave dhe akteve ligjore e nën ligjore;
- (8) Inspektoj sistemin e kontrollit të prodhimit të produkteve të ndërtimit sipas kërkesave të Ligjit, Nr. 02/L-14 për produktet e ndërtimit dhe vendosjen e sanksioneve sipas shkeljeve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 7 Përgjegjësitë

- 7.1. Inspektorët për mos zbatim të detyrave i përgjigjen Kryeinspektorit.
- 7.2. Inspektorët për mos zbatimin e detyrave, për shkeljen e tyre, për fshehjen e të dhënave dhe parregullsive si dhe për shpërdorim detyre dënohet sipas ligji.

Neni 8 Bashkëpunimi

- 8.1. Personat që kryejnë aktivitetet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Ligji, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Inspektoratin, për të ofruar çdo informatë relevante dhe për të lënë në dispozicion të Inspektoratit dokumentacionin që Inspektorati e gjykon si të nevojshëm për kryerjen e detyrave të veta sipas Ligjit.
- 8.2. Inspektorati vendos bashkëpunim me shërbime publike e jopublike për kryerjen e provave dhe analizave për produkte ndërtimore që kanë të bëjnë me sigurinë e personave, mjedisit dhe pronës.

Neni 9
Etika profesionale

9.1. Inspektorët duhet të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë të pavarur e profesionale, në pajtim me kriteret e inspektimit dhe dispozitat ligjore.

9.2. Inspektorët, gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të jenë të paanshëm dhe të ruajnë sekretin profesional, për gjithçka që informohen gjatë inspektimit.

Neni 10
Buxheti

10.1. Inspektoratit financohet nga Buxheti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

10.2. Mjetet që krijohen nga gjambat derdhen në buxhetin e konsoliduar Kosovës.

KREU III
BASHKËPUNIMI ME ADMINISTRATËN PUBLIKE

Neni 11
Bashkëpunimi me institucionet

Inspektorati bashkëpunon dhe koordinon punën me Ministrinë, inspektoratet përkatëse të tyre, policinë dhe institucionet publike që kryejnë veprimtari të ngjashme.

Neni 12

Inspektorati kërkon ndërhyrjen e menjëhershme të forcave të rendit kur:

- (1) Pengohet gjatë kryerjes së detyrës
- (2) Nuk zbatohet urdhër-pezullimi, urdhër-blokimi apo urdhër-konfiskimi i lëshuar.
- (3) Zbatohen vendime për asgjësimin e produkteve të parregullta.

KREU IV
PROCEDURA SIPAS ANKESËS

Neni 13

13.1. Kundër vendimit të Inspektorit mund të bëhet ankesë brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

13.2. Inspektorati është i obliguar që brenda afatit prej 30 ditësh të vendos sipas ankesës kundër vendimit të Inspektorit.

13.3. Kundër vendimit të Inspektoratit dhe heshtjes së administratës mund të ngritet padi në Gjykatën Supreme.

**KREU V
DISPOZITAT NDËSHKUESE**

Neni 14

14.1. Në shumë prej 250 deri 1.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:

1. Nuk i lejon inspektorit të produkteve të ndërtimit kryerjen e detyrave që parashihen në nenin 5 dhe 6 të këtij Ligji.
2. Nuk bashkëpunon me inspektorin sipas nenit 8 të këtij Ligji.
3. Përkundër kërkesës së inspektorit, nuk i dorëzon ose nuk i përgatit të dhënat dhe materialin apo dorëzon dhe përgatit materiale dhe të dhëna të pa sakta.

14.2. Në shumë prej 125 - 500 € do të dënohet për kundërvajtje, për shkeljet e parapara me këtë nen, personi përgjegjës i personit juridik.

**KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE**

Neni 15

Me qëllim të zbatimit të këtij Ligji Ministria nxjerrë akte nënligjore nga fusha dhe përgjegjësia e saj.

Neni 16

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohen të gjitha aktet ligjore në bazë të të cilave është ushtruar inspektimi i produkteve të ndërtimit.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-62
6 prill 2006**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha